



Mbro të dhënat e tua kur përdor telefonin smartphone dhe tablet

Bëni shumë kujdes në ruajtjen e informacionit personal në *smartphone* dhe *tablet* sepse këto të fundit mund të humbasin, të vidhen ose të sulmohen nga piratët elektronikë. Ju kurrë nuk duhet të mbani për shembull, fjalëkalimet, kodet e hyrjes dhe të dhënat bankare në mënyrë të dukshme. Nëse ju duhet të shisni apo dhuroni telefonin, merrni disa masa sigurie:

- Rivendosni parametrat e fabrikës;
- Hiqni kartën SIM dhe kartën e kujtesës;
- Fshini të gjitha *backups* të ruajtura në kujtesë.

GJEOLOKALIZIMI

Smartphone dhe *tablet* kanë funksione gjeolokalizimi, por jeni ju ata që vendosni nëse, kur dhe kush mund të njohë pozicionin tuaj. Për të çaktivizuar gjeolokalizimin, ju mund t'i fikni parametrat përkatës të *smartphone*-it ose *tablet*-ës tuaj

MBRONI TË DHËNAT TUAJA

Vendosni një PIN mjaft të komplikuar, duke shmangur, për shembull, të përdorni emrin tuaj, datën e lindjes, emrat e fëmijëve ose kafshëve shtëpiake, ose çfarëdo fjale tjetër që është lehtësisht e kopjueshme.

Vendosni një kod bllokimi që aktivizohet automatikisht kur telefoni është i ndezur por nuk është në përdorim për një kohë të caktuar. Gjithashtu, në këtë rast është mirë të shmangen kodet pak a shumë të lehtë për t'u zbuluar.

Kujdes! Ruani numrin IMEI, të cilin mund ta gjeni në kutinë e produktit që keni blerë dhe në rast të vjedhjes ose humbjes së aparatit tuaj *smartphone* ose *tablet* mund ta përdorni për ta bllokuar në distancë.

Sigurohuni që faqet e vizituara të përmbajnë protokollin e autentifikimit **https**. Kujdes të veçantë duhet pasur për sigurinë në përdorimin e faqeve bankare apo dhe emailit. Instaloni antiviruset.

Pas instalimit të një aplikacioni (app.), **kontrolloni** nëse kërkon qasje në përmbajtje të *smartphone*-it ose në *tablet*-ën tuaj (për shembull, foto apo kontaktet dhe lexoni me kujdes kushtet e përdorimit të shërbimit).

Kujdes nga *link-et* që ju shfaqen në email, mesazhe apo *chat-e* të ndryshme. Mund të përmbajnë viruse apo përmbajtje të tjera të padëshiruara.

Kjo broshurë është përgatitur në shembullim e fushatës ndërgjegjësuese të "Garante per la Privacy" "Fatti Smar".